



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1033 / Prot.
4

Tiranë, më 2 / 10 / 2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin farmaci "Elda" Tiranë.

REKOMANDIM

Nr. 30 datë 02 / 10 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, farmaci "Elda"

KONSTATOVA

Në datë 05//092013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, farmaci "Elda" me objekt:

- Plotësimi i formularit te njoftimit (neni 21).
- Masat lidhur me sigurinë e te dhënave personale (neni 27).

Parë në këndveshtrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe konkretisht sipas objektit të urdhërit të kontrollit administrativ, farmaci "Elda", në ushtrim të funksionit të saj merr cilësinë e kontrolluesit privat, pasi sipas përkufizimit në ligj "*Kontrollues*" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj. Në këtë aspekt ky kontrollues gjatë ushtrimit të aktivitetit të vet, bije në kontakt me të dhënat personale dhe sensitive të subjekteve të të dhënave personale, mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive të tyre.

Gjatë kontrollit administrativ u inspektua mbi dy aspekte, së pari mbi plotësimin e detyrimit ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe së dyti në masat e marra nga kontrolluesi për sigurinë e të dhënave personale. Nga kontrolli administrativ është konstatuar se kontrolluesi Farmaci "Elda" nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftim çka nga grupi i kontrollit është konsideruar shkelje e nenit 21 të

ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe është lënë detyrë për ta plotësuar brenda një afati kohor.

Gjithashtu është konstatuar se kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale të subjekteve të ndryshëm gjatë shërbimit që iu ofron në shenjen e medikamenteve të ndryshme, duke mbajtur dhe administruar recetat mjekësore. Të dhënat personale që pasqyrohen në këto receta janë ato që lidhen me emrin mbiemrin e pacientit moshën , informacione mbi llojin e medikamentit. Këto receta mjekësore kontrolluesi i administron duke i ruajtur në kuti ne ambjentin e vet për 5-vjet dhe më pas i shkatërron. U konstatua se kontrolluesi nuk është i lidhur me sistemin e ISKSH-se pasi është një farmaci që nuk është në skemën e ribursimit, në këtë mënyrë nuk mban të dhëna në rrugë elektronike.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar është konstatuar se nga ju si kontrollues mblidhen dhe përpunohen të dhëna personale nëpërmjet monitorimit të ambientit me kamera CCTV dhe nga grupi i kontrollit është konstatuar një mungesë e theksuar e njohurive të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe udhëzimit të veçantë nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” të cilët rregullojnë këtë lloj mbledhje dhe përpunimi të të dhënave personale. Me të drejtë në procesverbalin e mbajtur nga grupi i kontrollit kjo lloj mbledhje përpunimi të të dhënave personale është konsideruar në kundërshtim me ligjin e mësipërm për shkak të mospasjes së rregullave të shkruara lidhur me , qëllimin e mbledhjes, përpunimit, përcaktimin e aksesit, kohës së ruajtjes, vendosjes së tabelave të informimit.

Vlerësoj se mbledhja dhe përpunimi të dhënash personale nga kontrolluesi farmaci “Elda” nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV bëhet jo në respekt me kushtet dhe kriteret e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe udhëzimin e veçantë nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative,

REKOMANDOJ

Në zbatim të neneve 18, 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, kontrolluesi Farmaci Elda

1. Të marrë masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale, përdorimit të video-survejimit, regjistrim me kamera, (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Të bëjë informimin duke u vendosur tabelat informuese në vende të dukshme për përdorimin e video surveimit, sipas standardit të miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijani të këtij rekomandimi.

4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

